

Deforma zgjedhore

Dy vite pas, reforma në pikën zero



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Deforma zgjedhore

Dy vite pas, reforma në pikën zero

Prishtinë, shtator 2013

Copyright © 2013. Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të pjesëve të shkurtra për qëllime të kritikave apo vlerësimeve, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar etj., pa lejen me shkrim të D4D-së.

Përgatitur nga:

Leon Malazogu dhe Selatin Kllloqi me përkrahje hulumtuese nga Rasim Alija.

Ky raport është publikuar si pjesë e projektit për reformen zgjedhore, “Për përfaqësim të vërtetë në Kosovë” i financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës (FDFA). Përmbajtja e këtij raporti është në tërësi përgjegjësi e Demokracisë për Zhvillim (D4D).

Përmbajtja

- Përmbledhje, 4
- Hyrje, 6
- Procesi i reformës, 7
 - Për çfarë u nis?, 7*
 - Ku e lam e ku na mbeti?, 7*
 - Gabimi i lidhjes së reformës me zgjedhjet presidenciale, 9*
- Çfarë këshillon BE-ja?, 11
 - Vullneti politik për reformë dhe parandalim të manipulimit, 12*
- Zgjedhja e presidentit, 15
- Konflikti i interesit dhe Mandati, 18
- Menaxhimi i zgjedhjeve, 20
 - Përbërja e KQZ-së, 20*
 - Komisioni Komunal Zgjedhor, 21*
 - Menaxhimi i qendrave te votimit, 22*
 - Komisionerët të shërbejnë në komuna tjera, 23*
 - Vëzhgimi i zgjedhjeve, 23*
- Lista e votuesve dhe votimi me kusht, 25
 - Pastrimi dhe publikimi i listës së votuese, 25*
 - Vota me kusht dhe me postë, 26*
 - Votimi i diasporës, 27*
 - Dokumentet e pranueshme për të votuar, 29*
- Procesi zgjedhor, 31
 - Kohëzgjatja e fushatës, 31*
 - Identifikimi dhe shenjimi i votuesve, 31*
- Numërimi dhe drejtësia zgjedhore, 34
 - Vendi dhe mënyra e numërimit të votave, 34*
 - Rezultatet, 35*
 - Drejtësia zgjedhore, 36*
 - Gjykatat të ngadalshme dhe jofunksionale, 36*
- Përtej reformës elektorale, 39
 - Financimi i Partive politike, 39*
 - Regjistrimi i partive politike, 40*
- Konkluzionet, 41
- Konkluzionet e Forumit Reforma, 42
 - Aneksi I: Rezoluta e Kuvendit, 43*
 - Aneksi II: Marrëveshja politike, 45*
 - Aneksi III: Letra e BE-së, 46*
 - Aneksi IV: Qëndrimet e liderëve, 49*
- Fusnotat, 52
- Lista e publikimeve, 60
- Seria: Zgjedhjet, 62

Përmbledhje

Në vend se të nisej me qëllim për të parandaluar manipulimet, reforma u nis me qëllim për të krijuar zonat dhe për të zgjedhur presidentin drejtpërdrejtë nga populli. Komisioni për reformë zgjedhore bëri disa përmirësime, injoroi disa pika, por drafti u hodh tutje dhe e gjitha nisi nga e para nga liderët e fuqishëm politik.

Liderët politik kanë zhbërë një pjesë të përmirësimeve që kishte bërë Komisioni dhe së fundi ndërprejnë mbledhjet e rregullta. Në forum të liderëve janë ngritur çështje që deri tani nuk janë identifikuar si problematike por duket se u shkaktojnë kokëçarje disa partive. Ka tendenca për zhbërje të përparimeve të mëhershme, si p.sh. të lejohet që deputetët sërish të mbajnë poste ekzekutive.

Sa më tepër që vonohej reforma dhe afroheshin zgjedhjet, aq më shumë shtohej presioni tek opozita për të hequr dorë nga një pjesë e kërkesave. Sado që ata dëshironin zgjedhje të hershme, më tepër frikësoheshin nga mundësia e shkuarjes me ligjin e vjetër që i jep epërsi të jashtëzakonshme partisë kryesore si edhe dy partive tjera me kontroll të theksuar në disa rajone.

Pas disa viteve të këshillave si verbale apo nëpërmjet raporteve të ndryshme, shtetet anëtare të BE-së dhe zyra e BE-së hartuan një dokument të shkurtër që kërkon nga liderët politik që të përshpejtojnë procesin e reformës zgjedhore duke futur edhe hisedarë tjerë në këtë proces dhe sugjeron një sërë përmirësimesh të tjera. Ndër të tjera, BE sugjeron heqjen e votës preferenciale, përdorimin e ngjyrës së zezë për shenjim se është votuar, përmirësojë raportimin e mediave, të mbajë zgjedhjet lokale në afat kohor, etj.

Problemet tjera si drejtorët e shkollave, përbërja e KKZ-ve, heqja e votës me kusht dhe votimit përmes postës për zgjedhjet lokale, publikimi i hershëm i listës votuese, puna e

gjyqësorit, qartësimi se me cilat dokumente mund të votohet kanë zënë vend në diskutimet e liderëve politikë por disa nga këto edhe në shkresën e BE-së.

Disa vendime të liderëve partiakë bien në kundërshtim me sugjerimet e BE-së, siç është vendimi që votat të numërohen në një qendër komunale. Zgjedhje të kontestuara me arbitër të kontestuar dhe që nuk ka kredibilitet për të zgjidhur kontestet është skenari i cili mund të shpie në dhunë politike.

Në këtë publikim, D4D prezanton këto dy dokumente, dhe paraqet se ku jemi tani, me qëllim që të ushqejë debatin për reformë zgjedhore i cili me siguri se do të fillojë menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve lokale.

Hyrje

Pas një kohe të gjatë, Kosova pati tri vite që të pushojë nga kalendari zgjedhor. Nga viti 2011 deri më 2013, politikbërësit tanë kishin një rast të veçantë për të ndërmarrë reforma rrënjësore pa u hutuar nga populizmi zgjedhor.

Brenda këtyre tri viteve, reforma zgjedhore shumë herë u nis dhe u bllokua. Sa herë rinisej reforma, shpresat tona për zhbllokim këndelleshin, por ambiciet e ‘reformatorëve’ shkonin duke rënë. Debatet mediale filluar t’i referohen procesit si ‘deformim’ zgjedhor.

Herën e fundit që shpresuam se mbase diç modeste mund të ndodhë ishte pranvera e vitit 2013 kur u publikuan dy dokumente. Një dokument dy faqësh reflekton një listë parimesh të cilat i kanë hartuar shtetet anëtarë të Bashkimit Evropian dhe të cilat presin përgjigje nga lidershipi kosovar.

Dokumenti tjetër reflekton mendimet e liderëve të partive të cilët kishin filluar të harmonizojnë qëndrimet i cili u bë publik nga AKR-ja si mikpritëse e takimit të fundit të forumit të liderëve.

Të dy këto dokumente janë indikatorë të drejtimit të cilin mund të marrë reforma pas zgjedhjeve lokale kur edhe mund të rinisin diskutimet.

Procesi i reformës

Për çfarë u nis?

Çdo vlerësim i gjendjes së tanishme kërkon një rishikim të motiveve me të cilat u fillua reforma në radhë të parë. Marrëveshja politike e liderëve e arritur në pranverë të vitit 2011 u bazua në dy objektiva

Në mes tjerash, të përkrahë krijimin e më shumë distrikteve zgjedhore, dhe Zgjedhjen e kryetarit të vendit me vota të qytetarëve.¹

Fjala kryesore këtu është 'në mes tjerash', sepse mungonte ajo që brengoste më së shumti qytetarët – në vend se të nisej reforma me qëllim për të parandaluar manipulimet, ajo u nis me qëllim për të krijuar zonat dhe për të zgjedhur presidentin drejtpërdrejt. Për të arritur dy kërkesat kryesore, liderët kryesorë u pajtuan për dy pika veprimi,

Të formojnë menjëherë një Komision për Reformën e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i cili kishte për detyrë hartojë ndryshimet e nevojshme legjislative dhe kushtetuese;
Caktuan afat 8-12 muaj nga data e themelimit të komisionit dhe i dhanë opozitës që të udhëheqë punën e komisionit.²

Reforma e filluar ka stagnuar si pasojë e kalkulimeve të gabuara partiake në kurriz të shtetit të Kosovës. Këtë më së miri e dëshmon edhe vendimi i fundit për krijimin e komunave të reja pak para zgjedhjeve lokale.

Ku e lam e ku na mbeti?

Nga puna e komisionit, diskutimi kaloi në format të diskutimit në mes të liderëve më të lartë politik për t'u shuar tërësisht disa muaj më vonë. Liderët politik nuk lejuan edhe atë pak reformë të cilën morri guxim që të sjell komisioni parlamentar. Liderët "rrëmbyen" agjendën nga ky komision

i mandatuar dhe e vunë në funksion të agjendës së ngushtë politike.

Problemi së pari është parimor sepse me këtë zhvendoset vendimmarrja nga Kuvendi ku e ka vendin në një forum të mbyllur joformal. Kjo nuk është hera e parë që ndodh një zhvendosje e tillë – edhe më herët ishte krijuar një Grup Punues (i udhëhequr nga OSBE dhe Kryesuesja e KQZ-së) i cili defaktorizoi Kuvendin.

Herën e parë krijimi i grupit punues u arsyetua me mungesë të ekspertizës në Kuvend. Zhvendosja tek forumi i liderëve u bë me arsyetimin se kanë mbetur vetëm çështjet më politike. Edhe pse në formate të ndryshme, të dy zhvendosjet nga Kuvendi përjashtuan jo vetëm publikun por edhe pjesën dërrmuese të partive. Në masë të madhe, ky diskutim mëtonte një marrëveshje të liderëve që mund të rezultonte vetëm fuqizimin e tyre në llogari të të tjerëve brenda partive të tyre.

Takimi i fundit i liderëve më 23 prill dhe letra e BE-së janë shkas për këtë punim. Takimi i radhës ishte thirrur nga Aleanca Kosova e Re (në vazhden e takimeve të thirrura nga liderë të ndryshëm) dhe duket se janë harmonizuar mjaft nga qëndrimet.

Ky ishte takimi i fundit i tillë jo vetëm për shkak se afrohej periudha zgjedhore sepse mund të shfrytëzoheshin edhe disa muaj para se vendi të hynte në agjendë të zgjedhjeve lokale. U lëshua rasti që disa nga përmirësimet teknike të hynë në efekt për zgjedhjet lokale. Më tepër se dy vjet më vonë, është arritur tejet pak dhe dhe u lëshua rasti disa nga përmirësimet teknike të hyjnë në efekt për zgjedhje lokale.

Forum i liderëve dështoi për shkak se AAK vendosi t'i bojkotojë këto takime dhe lideri i VV-së deklaroi se ai shkon aty në radhë të parë për të marrë informata dhe për t'i treguar opinionit se çfarë flitet pas dyerve të mbyllura.³ Arsyet për dështimin e reformës në përgjithësi janë tjera.

Gabimi i lidhjes së reformës me zgjedhjet presidenciale

Së pari, ligji i tanishëm iu shkon për shtatishumicës së partive të cilat nuk dëshirojnë që të mbyllet hapësira për manipulim. Vëzhgimi ynë i diskutimeve në komision parlamentar, grup punues, si dhe në KQZ na kanë bindur se përveç partisë në pushtet, ka mjaft zyrtarë të partive tjera që janë rezistentë ndaj ndryshimeve pozitive.

Pengesa e dytë ishte lidhja e zgjedhjeve presidenciale me përfundim të reformës. Sipas marrëveshjes, zgjedhjet presidenciale duhej të mbasheshin

jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe legislative hyjnë në fuqi⁴

Për të vonuar zgjedhjet presidenciale (për të cilat disa parti të mëdha kishin rezerva), ka mjaftuar që të vonojnë reformën. Në këtë aspekt, reforma është bërë viktimë e mungesës së vullnetit për të parin e vendit.

Sa më tepër që vonohej reforma dhe afroheshin zgjedhjet, aq më shumë shtohej presioni tek opozita për të hequr dorë nga një pjesë e kërkesave. Sado që ata dëshironin zgjedhje të hershme, më tepër frikësoheshin nga mundësia e shkuarjes me ligjin e vjetër që i jep epërsi të jashtëzakonshme partisë kryesore si edhe dy partive tjera me kontroll të theksuar në disa rajone.

Në një tryezë të organizuar nga Forumi 2015 dhe D4D me rreth 100 pjesëmarrës, mbi gjysma menduan që

partitë e mëdha nuk janë të interesuara për të gjetur zgjidhje për manipulimet "industriale" të votës së lirë, sepse tashmë e kanë përpunuar sistemin vetanak për të qenë pjesë e kësaj industrie manipuluese, dhe nuk shohin forca tjera që do ta trazonin këtë situacion.

Rreth 33% si shkas për mungesë të reformës i panë:

Liderët e partive të mëdha politike e kanë marrë procesin zgjedhor përmbi vete, për të siguruar sistem që do t'i shkojë për shtati arritjes së votave maksimale për veten e tyre, për tu konfirmuar si liderë të padiskutueshëm brenda dhe jashtë partisë që e udhëheqin.⁵

Vetëm 11% të mbetur panë arsye më pozitive për ngeçje të reformës apo kanë menduar se reforma është duke ecur mirë.

Pikërisht në këtë periudhë të paqartë vie edhe një dokument dy faqësh nga Bashkimi Evropian i cili mund t'i jep drejtim reformës.

Çfarë këshillon BE-ja?

Përafërsisht në të njëjtën kohë, bashkësia ndërkombëtare e kryesuar nga Bashkimi Evropian arrin konsensus për parimet që duhet të përcjellë Kosova gjatë reformimit të ligjit të saj zgjedhor. Pas disa viteve të diskutimeve pa praninë e kosovarëve dhe pa përfshirjen e SHBA-ve, shtetet anëtare të BE-së arrijnë pajtim për pritjet nga Kosova. Këtë herë ato nuk prezantohen si listë që do t'i imponohet Kosovës, por raporti i progresit në vjeshtë medoemos do të vlerësojë nëse këto janë arritur apo jo. Më saktë, dokumenti⁶ nga zyra e BE-së kërkon që

liderët politik të përfundojnë diskutimet pa vonesa, si dhe të përfshijnë shoqërinë civile dhe hisedarë tjerë dhe të përfundojnë diskutimet duke miratuar ndryshimet adekuate në Kuvend.⁷

Shkresa nuk e qartëson afatin kohor kur duhet kthyer diskutimin në Kuvend. Duke pasur parasysh traditën elektorale evropiane, shkresa duhet të interpretohet si kërkesë që vendimet nuk duhet të harmonizohen vetëm nga liderët partiakë, si një proces skajshmërisht i mbyllur dhe jodemokratik, por duhet zgjëruar procesin.

Zgjedhjet gjithashtu janë viktimë e ndryshimit të mënyrës se si e mbikqyr bashkësia ndërkombëtare Kosovën. Më parë, Kosovës i përshkruhej detajisht se çfarë duhet bërë, që nuk linte hapësirë as për rezistencë politike, as për kreativitet, dhe as për vonesa.

Me fitimin e më shumë sovraniteti, Kosova tani ka filluar të trajtohet si shtet. Si vend aspirues drejt Evropës, tani Bashkimi Evropian ka zëvendësuar rolin e ICO-së dhe deri diku edhe të SHBA-ve si burimi kryesor i udhëzimeve për politik-bërje.

Ky zëvendësim sjell disa epërsi por edhe mangësi. BE-ja nuk ka praktikë unike evropiane për zgjedhjet kështu që nuk

mund t'i përshkruajë detajisht Kosovës se çfarë duhet bërë. Për të konkluduar se çfarë duhet bërë, dialogu vendor bëhet i domosdoshëm ashtu si edhe kërkimet dhe konsultat për praktikën më të mira zgjedhore ndërkombëtare. Nxjerrja e këtij dokumenti nga BE duhet parë në këtë aspekt si udhëzim i përafërt se çfarë duhet bërë kosovarët. Prandaj edhe kërkesa e përgjithshme e rekomandimit kryesor:

Reformë për të siguruar zgjedhje të lira, të drejta dhe demokratike⁸

Një pikë specifike kishte të bënte me datën e zgjedhjeve lokale që tërhoqi vërejtjen për kornizën ligjore dhe këshilloi kundër zgjatjes apo shkurtimit të mandatit për qëllime kalkulative. BE insistoi që zgjedhjet lokale 2013 të mbahen brenda afatit ligjor, jo para 22 shtator 2013 dhe jo më vonë se 15 dhjetor 2013; dhe se presidentja mund të shpall datën jo më herët se 22 mars 2013 dhe jo më vonë se 15 gusht 2013.⁹ Tentativat për mbajtjen e hershme apo shtyrjen e tyre përfunduan.

Vullneti politik për reformë dhe parandalim të manipulimit

Mungesa e besimit në reformë gjithashtu vërehet nga anketa e mëhershme në tryezë të diskutimit. Gjysma e respondentëve menduan se

vetëm një pjesë e vogël, pothuajse neglizhuese, e teknikave manipulative që përdoren gjatë zgjedhjeve që mund të evitohen me ligj apo procedura administrative adekuate. Pjesa më e madhe e tyre vjen si rezultat i dhunës së ushtruar nga militantë partiak ndaj këtyre procedurave, që vështirë është të ju kundërvihesh me ligj, rregulla dhe procedura.

Gjysma tjetër menduan se nëse

KQZ-ja, Ministria e Brendshme, ODHIR, shoqëria e gjerë civile dhe institucione tjera me rol në zgjedhjet politike e

bëjnë punën e tyre si duhet, manipulimeve zgjedhore do të ishin minimale dhe të tolerueshme. Si të tilla do t'i mbyllnin dyert për manipuluesit potencial.¹⁰

Zgjedhjet e vitit 2010 u quajtën zgjedhje të qeta, dhe përzgjedhja e fjalës 'të qeta' nga zyrtarë të lartë të BE-së¹¹ nuk është e rastësishme. BE nuk dëshironte të lavdëronte një proces të manipuluar, por nuk ishte momenti për qortim të Kosovës sepse duhej hyrë në dialog me Beogradin. Të njëjtin cilësim më vonë e përdor edhe raporti i një eksperti të BE-së.¹²

Por tani duket se ngadalë tiparet kryesore të zgjedhjeve kanë filluar të priorizohen. Raporti i EU EEM kishte vlerësuar sistemin e tanishëm zgjedhor si

Të komplikuar për tu kuptuar nga elektorati i gjërë¹³

Për të trajtuar këtë diagnozë, dokumenti i BE-së kërkon që Kosova të sjellë një sistem të thjeshtë dhe transparencë të legjislacionit zgjedhor si dhe procedurë të thjeshtë të votimit¹⁴

Për shkak se këshillat janë tejet të përgjithshme, ato kërkojnë interpretim dhe diskutim se si duhet të zbatohen në Kosovë. Shkresa shprehimisht sugjeron që një mënyrë e thjeshtësimi është heqja e votës preferenciale. Ka kohë që D4D ka rekomanduar që votimi të bëhet vetëm për një kandidat në fletëvotime me emra. Thjeshtësimi është kërkuar edhe më herët, edhe pse shoqëria civile kërkon që mos të sakrifkohet cilësia e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes.¹⁵ Punimi i cituar më lartë është prezantuar në një tryezë për integrim drejt BE-së sa i përket zgjedhjeve dhe ofron udhëzim si të interpretohen disa nga këshillat e përgjithshme të BE-së.

BE-ja kërkon që partitë politike të shprehin vullnet të qartë politik për të parandaluar përsëritjen e parregullsive sikur në zgjedhjet e vitit 2010. Përveç që dokumenti në mënyrë explicite pranon parregullsitë masive të vitit 2010, porosia e

qartë është se kësaj radhe përsëritja e atyre parregullsive nuk do të mbetet pa u ndëshkuar nga komuniteti ndërkombëtar.

Rekomandimet tjera trajtohen në pjesët në vazhdim të punimit i cili diskuton temat e ngritura nga takimet e liderëve dhe dokumenti i BE-së. Temat që kanë të bëjnë me sistemin zgjedhor janë përfshirë në një publikim tjetër që botohet më vonë, përderisa ky punim përqendrohet në vetë procesin dhe në pikat konkrete për parandalim të manipulimeve dhe pika tjera të cilat nuk kanë të bëjnë me reformën sistemore. Këtu janë përfshirë risitë që kanë të bëjnë me menaxhimin, listat e votuesve, procesin zgjedhor dhe përfundon me një listë të rekomandimeve.

Zgjedhja e presidentit

Një dëshpërim i qytetarëve me tërë elitën politike i ka shtyrë që të kërkojnë shpëtimin tek një super-person imagjinar, i cili do të pastrojë tërë skenën politike nga korrupsioni që e ka kapluar. Një pritje e tillë naive është joreale dhe gjasat janë që presidenti do të zgjedhet pikërisht me vullnetin e partive dhe se gjasat se një lider i freskët mund të depërtojë nga jashtë dhe të sfidojë elitën e etabluar janë skajshmërisht të vogla. Ky përcëpim popullor ka shtyrë edhe partitë që në mënyrë populiste të deklarohen për një president që zgjedhet drejtpërdrejtë edhe pse këtë ata qartazi nuk e preferojnë. Deklaratat e disa partive pro zgjedhjes së drejtpërdrejtë bëhen:

- (a) Për t'u paraqitur si reformistë para qytetarëve;
- (b) Sepse mendojnë se kanë kandidat të mirë; ose
- (c) Sepse mendojnë se me këtë ja vështirësojnë partive tjera.

Shumica kanë llogaritur se më mirë është që të deklarohen për diç që ju pëlqen qytetarëve se mos fitojnë ndonjë votë. Tabela më poshtë tregon qëndrimet e proklamuar liderëve të partive siç janë rezytuar në mbledhjen e fundit të liderëve.

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Zgjedhja e Presidentit (neni 86)	Nga qytetarët	PO	X*	X			X	X	X	X	
	Nga Kuvendi	JO	X*		X						

Është interesante se të gjithë paskan dëshirë që presidenti të zgjidhet drejtpërdrejtë, por kjo assesi të vendoset dhe as nuk është fare në agjendë. Madje edhe partitë e vogla të cilave kjo nuk u konvenon nuk dëshirojnë që t'u ikë ky tren. Fuqia e partive të vogla në Kuvend qartazi zvogëlohet nëse nuk janë pjesë e pazareve për të arritur 2/3 e votave për të zgjedhur presidentin. Mbase presin se me një super-kandidat mund të fitojnë besimin e popullit dhe të gjejnë një rrugë të shkurtër për të zvogëluar hendekun me partitë e

mëdha. Është mirë që bashkësia ndërkombëtare nuk është deklaruar fare për këtë çështje e cila duhet të jetë pjesë e agjendës që u përket vetëm kosovarëve.

Zgjedhja e drejtpërdrejtë ka qenë një nga pikat në të cilën janë pajtuar liderët në marrëveshjen e para dy viteve. Por tani mundemi lirisht të konkludojmë që marrëveshja atëherë nuk ishte e sigurtë dhe pati të vetmin qëllim vonesën e reformës dhe vonesën e zgjedhjeve presidenciale.

Për më tepër, rrethanat kanë ndryshuar në ndërkohë. Së pari, kanë ndryshuar kalkulimet se cilët kandidatë mund të fitojnë, prandaj subjektet janë ripozicionuar. Së dyti, Komisioni për Reformë Kushtetuese ka rekomanduar zvogëlimin e kompetencave të presidentit të ardhshëm (nëse kalojnë ndryshimet) dhe me këtë argument për zgjedhje të drejtpërdrejtë zbehet.¹⁶

Edhe shoqëria civile nuk ka mendim të njëjtë. Forumi "Reforma" i përbërë nga shoqëria civile nuk ka arritur konsensus të prerë për këtë pikë. Ka mbizotëruar ideja e zgjedhjes së presidentit drejtpërdrejtë nga populli por me kusht që ndryshimet kushtetuese ti japin më shumë fuqi presidentit. Nëse kompetencat mbasin si tani, atëherë nuk ka logjikë zgjedhja e drejtpërdrejtë.

Ka argumente të bollshme se zgjedhja e drejtpërdrejtë mund të shkaktojë konfuzion në mes të kompetencave të Qeverisë, Kuvendit dhe Presidencës. Në një demokraci jo të konsoliduar dhe të varur nga qarqe të fuqishme jo-institucionale, ndryshimi i sistemit nga ai parlamentar në sistem miks me gjasë do të sjellë kokëçarje të mëdha. Edhe demokracitë mirë të etabluara (si p.sh. Franca) dëshmojnë se konfuzioni i kompetencave mund të shkaktojë sfida që vështirë tejkalohe.

Ka gjithashtu propozime që presidenti i cili zgjedhet nga Kuvendi të votohet vetëm me votën e 2/3 të deputetëve dhe të hiqet mundësia që në raundin e tretë të votohet me

shumicë të thjeshtë. Një propozim i tillë do të ulte dominimin e dy partive më të mëdha dhe do të impononte një konsensus më të gjerë që rrjedhimisht do të sillte një President/e me bazë të gjerë legjitimiteti. Por në mungesë të maturisë së partive kryesore, ka mundësi që vendi të zhytet në kaos dhe zgjedhje të njëpasnjëshme për president.

Konflikti i interesit dhe Mandati

Dëshmia më e mirë se reforma shkon prapa është hapja e dy temave që deri tani kanë siguruar deri diku një pavarësi si të deputetëve ashtu edhe të një sërë postesh të rëndësishme. Ka tendenca për të bërë deputetët më të varur drejt liderëve si dhe për të politizuar policinë, gjyqësorin, prokurorinë dhe institucione tjera të rëndësishme.

Gjyqtarët, prokurorët, pjesëtarët e policisë, e të tjerë nuk mund të garojnë pa dhënë dorëheqje paraprakisht, siç e rregullon kushtetuta (neni 73).¹⁷ Ky konflikt i interesit nuk është ngritur asnjëherë si problematik gjetiu, por qartazi krijon pengesa tek disa nga liderët të cilët dëshirojnë që të mënjanojnë këtë kufizim.

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Posti i fituar me votë të qytetarit	I pamund. kand. gjatë mandatit, (neni 73)	PO	X				X	X	X	X	
	Me rastin e kandidimit jep dorëheqje	PO									
	Siç është aktualisht	JO		X*	X*						

Mund të deshifrohet se partitë në koalicion kërkojnë ndryshim kushtetues për të zhbërë këtë ndarje kushtetuese në mes të posteve të rëndësishme apolitike me ç'rast ato do të politizoheshin ndjeshëm. LDK dhe VV kanë votuar që të ruajnë këtë ndarje të qartë në mes të politikës dhe shërbimit civil.

Deri para disa viteve, deputetët kosovarë mund të shërbenin si ministra edhe pse kjo ishte shkelje drastike e parimit të ndarjes së pushteteve në mes të legjislativit dhe ekzekutivit. Vetëm pas disa mandateve, Kosova mori një vendim të vështirë, ku deputetëve iu ndalua që të shërbenin. Vënia e kësaj pike në agjendë zbulon se kjo ndarje ka armiq dhe disa nga liderët dëshirojnë që të zhbëjnë këtë vendim. Neni 72 që thotë:

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nuk mund të mbajë ndonjë post ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike, dhe as të ushtrojë ndonjë

funksion tjetër ekzekutiv, sikurse është përcaktuar me ligj.¹⁸

Kosova menzi ka zgjedhur këtë problem i cili u rezistua gjatë nga ministra të cilët ruanin postet e deputetit. Tani sërish ai është vënë në shënjestër nga koalicioni qeverisës që kërkon ndryshimin.

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Deputeti i zgjedhur mund të jetë edhe post ekzekutiv (neni.72)	PO	X				X	X	X	X	
Siç është aktualisht	JO		X*	X*						

Trendi i votimit edhe për këtë pikë ishte i ngjashëm ku opozita ka votuar pro ruajtjes së nenit aktual.

Menaxhimi i zgjedhjeve

Një nga problemet kryesore që kanë zgjedhjet e Kosovës është pikërisht institucioni që menaxhon ato, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për këtë punim kemi ndarë pesë pika që janë subjekt qoftë i diskutimeve në mes të liderëve apo brengë e BE-së.

Përbërja e KQZ-së

Një nga problemet në KQZ është mungesa e opozitës dhe mbivotimi i shpeshtë, temë të cilën shoqëria civil e ka ngritur shpesh në të kaluarën. Forumi 'Reforma' dhe D4D kanë propozuar një balancim politik në mes të pozitës dhe opozitës brenda KQZ-së. Nuk është për t'u çuditur që partitë opozitare e kanë përkrahur këtë model, të cilin e kanë kundërshtuar partitë në koalicion. Deklarimi i kryetarit të PDK-s¹⁹ për ndarjen e KQZs në 70% për opozitën dhe 30% për pozitën mbetet vetëm një deklaratë joshëse për publikun përderisa në takimet e liderëve PDK-ja i mbetet besnike kërkesës që përbërja e KQZ-së të mbetet ashtu siç është tani. Qëndrimet në forumin e liderëve paraqiten më poshtë.

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Përbërja e KQZ-së (neni 139)	50% pozita + 50% opozita		X	X						
	70% pozita + 30% opozita	PO								
	Siç është aktualisht	PO JO	X			X*	X	X	X	

* AKR dakordohet për variantin e parë por ofron konsensus edhe për variantin e tretë!

KQZ ka rol të organizatorit të zgjedhjeve dhe pjesërisht edhe të arbitrit dhe si i tillë nuk mund të jetë i anshëm. Vërehet që opozita ka dilema serioze sa i përket paanshmërisë së KQZ-së gjë që duhet trajtuar, nëse jo duke balancuar 50-50 mes pozitës dhe opozitës atëherë në një formë tjetër që fiton përkrahjen e tyre.

Nëse në KQZ vazhdon të ketë mbi-votim të theksuar, e pamundëson atë të kryejë rolin e arbitrit të paanshëm që mund të rrezikojë mosbindjen e opozitës ndaj rezultateve në të ardhmen. Zgjedhje të kontestuar me arbitër të

kontestuar dhe që nuk ka kredibilitet për të zgjidhur kontestet është skenari i cili mund të shpie në dhunë politike. Udhëheqja e sekretariatit me ushtrues detyre të kryeshefit për dy vite dhe vështirësia e përzgjedhjes së kryeshefit të ri janë ilustrime të politizimit të skajshëm jo vetëm të KQZ-së por edhe sekretariatit si organit profesional dhe i përhershëm.

Komisioni Komunal Zgjedhor

Se nuk ka besim edhe në nivele më të ulëta të menaxhmentit zgjedhor tregon edhe vota e VV-së dhe AKR-së ku kërkojnë që edhe komisionet komunale zgjedhore të kenë detyrat e përcaktuara me ligj dhe jo ti lihet KQZ-së që të përcaktojë këto në mënyrë diskrecionale.

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Detyrat e komisionit komunal të zgjedh.	Siç është aktual.(me udhëzim të KQZ-se) Detyrat ti përcaktohen me ligj	JO	X	X				X	X	X	
		JO			X*		X*				

* VV dhe AKR janë për variantin e dytë!

Në shumicën e rekomandimeve që vijnë nga bashkësia ndërkombëtare dhe nga organizatat vendore kërkohet që shumë rregullore të KQZ-së të shkrihen në ligj zgjedhor. Ky është një nga komentet kryesore që burojnë nga raporti i EU EEM dhe nga ENEMO.²⁰

D4D dhe Forumi Reforma me kohë kanë kërkuar që shumica e rregulloreve të KQZ-së të shkrihen në ligj dhe ti ngushtohet hapësira KQZ-së për të interpretuar ligjin përmes rregulloreve sipas disponimit politik ditor të shumicës në KQZ. Vetë përbërja politike e KQZ-së krijon mundësinë e politizimit të KQZ-së prandaj përcaktimi i detyrave me ligj zgjedhor do të ishte zgjidhje më e mirë.

Është interesant qëndrimi i LDK-së dhe AAK-së në këtë rast që është i njëjtë me partitë në pushtet përderisa AKR-ja që është në pushtet ka qëndrim të kundërt. Kjo shpjegohet lehtë pasi që edhe pse AKR është në koalicionin qeverisës në nivelin qendror, nuk ka asnjë komunë nën kontroll ku mund

të shfrytëzojë epërsinë e shumicës lokale për të ndikuar tek KKZ-ja. Vetëm subjektet si VV dhe AKR që nuk kanë komuna të cilat i qeverisin nuk janë në favor. Konkluzioni lehtë nxjerret se kontrollimi i komunave u jep partive kontroll të ndjeshëm edhe mbi KKZ-të.

Menaxhimi i qendrave te votimit

Mosbesimi është edhe më i theksuar tek roli i drejtorit të shkollës. Përveç PDK-së që ka “kërkuar konsultime shitesë”, të gjitha subjektet janë shprehur që menaxheri i qendrës së votimit të zgjedhet me konkurs dhe kjo detyrë mos t’i lihet drejtorit të shkollës. Forumi Reforma dhe D4D për një kohë të gjatë ka kërkuar që roli i drejtorëve si menaxherë të qendrave të votimit të rishikohet duke u bazuar në përvojën e deritashme të monitorimit të zgjedhjeve kur në shumë raste drejtoret kanë kaluar kompetencat e tyre dhe janë vënë në shërbim të politikës.

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Menaxhimi i qendrave të votimit	Drejtori i shkollës - menaxher (aktualisht)	JO	*								
	Menaxheri me konkurs	JO	*	X	X		X	X	X	X	

* PDK-së i nevojiten konsultime shitesë!

Përkrahja e këtij opsioni nga shumica e partive politike shihet si lëvizje pozitive. Zgjedhja me konkurs mënjanon një figurë politike dhe hap rrugë për të kërkuar një formulë apolitike. Por edhe ndryshimi është i vështirë. Fundi i fundit, edhe drejtorët janë zgjedhur me konkurs por dalin të jenë figura politike. Ashtu siç manipulohen konkurset për përzgjedhjen e drejtorët, mund të manipulohet edhe konkurset për përzgjedhjen e menaxherëve të qendrave të votimit. Shërbimi civil i politizuar në Kosovë është dëshmi se konkursi nuk është garancë.

Duke pasur rezerva me cilëndo mënyrë që mund të vendoset kjo çështje, është me rëndësi që përgjegjësitë e menaxherit të qendrës (drejtor shkolle apo jo) që të përcaktohen në detaje, përfshirë heqjen e turmave nëpër korridore dhe të

mbajë përgjegjësi ligjore si për shkelje ashtu edhe për neglizhencë nëse nuk ka ndërmarrë asgjë në këtë drejtim.

Komisionerët të shërbejnë në komuna tjera

D4D dhe Forumi Reforma kanë inicuar një ndryshim në administrimin e zgjedhjeve, duke propozuar që në ditën e zgjedhjeve, komisionarët mos të shërbejnë në komunën e tyre. Është argumentuar mjaft në disa punime²¹ që solidariteti i komisionerëve ndaj lokalitetit prej nga vijne është më i lartë sesa që është llogaria profesionale ndaj KQZ-së. Andaj vendosja e tyre në zona tjera rrit profesionalizmin dhe ulë edhe motivin dhe mundësinë për keqpërdorime.

Forum i Reforma ka dërguar këtë kërkesë tek Komisioni i Kuvendit për Reformë Zgjedhore të cilët e kanë trajtuar. Ky propozim mblodhi mjaft vota por nuk kaloi vetëm për një votë.

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Komisionerët	Siç është aktualisht	JO	X	X	X		X	X	X	X	X
	Edhe nga komunat tjera	JO					X*				

Konkluzion: Miratohet!

** AKR propozon variantin e dytë por ofron konsensus edhe për variantin e dytë!*

Si inicues të kësaj teme jemi të kënaqur që një propozim i tillë është gjetur në agjendë të liderëve, por duhet të shprehim dëshpërimin me votimin e tyre. Për fat të keq, mbledhitë e liderëve duket se kanë qenë edhe më konzervative dhe e kanë refuzuar tërësisht.

Vëzhgimi i zgjedhjeve

Liderët dhe partitë vazhdimisht kërkojnë vëzhgim nga jashtë, por nëse do të ketë vëzhgim apo jo nuk varet nga thirrjet tona. OSBE dhe BE nuk vëzhgojnë zgjedhjet kryesisht për shkak që nuk kanë pranuar Kosovën si shtet të pavarur. Herën e fundit, i vetmi vëzhgim serioz nga jashtë ishte një misioni i përbërë nga OJQ-të ndërkombëtare, të

organizuara nën emblemën ENEMO. BE thërret që

të hulumtohen mundësitë që Këshilli i Evropës të ketë Mision vëzhgues për zgjedhjet lokale²²

Një arsye tjetër pse ODIHR nuk vie si vëzhguese në Kosovë, është roli aktiv i OSBE-së në organizim të zgjedhjeve. Marrëveshja Kosovë-Serbi i ka dhënë mandat organizativ OSBE-së për organizimin e zgjedhjeve në veri. Si rezultat, Kosova nuk mund të ftojë ODIHR-in as në vitin 2013 dhe 2014 por tani duhet të insistohet që OSBE të ketë rol të fortë vëzhgues dhe monitorues të tërë procesit zgjedhor dhe të hartojë raporte ngjashëm siç bën për drejtësinë në Kosovë.

Përveç vëzhgimit nga bashkësia ndërkombëtare, duhet të bëhet çmos që të rritet mundësia që vëzhguesit vendor të jenë në gjendje që vërtetë të inspektojnë procesin zgjedhor. Duhet të disiplinohen vëzhguesit e subjekteve, të zvogëlohen turmat e militantëve në korridore, mos të thirren votuesit në telefon në ditën e zgjedhjeve, të ruhet pozicioni i vëzhguesve i cili ishte arritur me zgjedhjet në Ferizaj, të kthehen kabinat e votimit ashtu që votuesi të jetë me shpinë nga vendvotimi.

Lista e votuesve dhe votimi me kusht

Pastrimi dhe publikimi i listës së votuese

Një temë teknike si mirëmbajtja e listës së votuesve nuk mund të përfitojë shumë nga deklaratat e liderëve. Rekomandimi për përfshirje të burimeve të ndryshme (si MPB, regjistrimi i popullsisë) duket i mirë për sy, por realisht fare nuk i kontribuon procesit. Regjistrimi i popullatës është një proces tërësisht i ndarë nga listat e votuesve dhe rezultatet fare nuk mund të përdoren për lista.

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Përpunimi i listave të votuesve	KQZ+MPB+Agj. i regjistrimit të popullsisë Siç është aktualisht	JO JO	* *	X X	X X		X X	X X	X X	X X	

* PDK-së i nevojiten konsultime shitesë!

Deklarimi i tillë i liderëve zbulon alarmin se diç duhet bërë, por ka pak ide se çfarë duhet bërë. Kjo domosdo shpie në dëshpërim apo në dyshime të ndërsjella.

D4D dhe Forumi Reforma kanë publikuar disa opsione për riparimin e listës, por me afatin kohor që ka mbetur, pak mund të bëhet për zgjedhjet komunale në vjeshtën e vitit 2013. Edhe BE ka kërkesë konkrete për afatin kohor për zgjidhjen e këtij problemi, por nuk tregon se si duhet zgjidhur. Pika 7 thotë

Të rregullohen listat së paku tre muaj para zgjedhjeve.²³

Pika 14 kërkon

Të qartësohen kompetencat e institucioneve që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor përfshirë konsolidimin e databazës së popullatës (lexo: regjistrin civil) për të mundësuar një listë të përmirësuar të votuesve.²⁴

Në kuader të projektit 'Përmirësimi i listës votuese' gjatë vitit 2012-2013, KQZ ka larguar 11,097 emra nga lista votuese, ndërsa që nga viti 2000 ka larguar gjithsej 52,451 emra të personave të vdekur.²⁵ Gjithashtu KQZ thotë se së fundi ka larguar rreth 30,000 emra duke përfshirë emra të

personave të vdekur si dhe të atyre që kanë hequr dorë nga nënshtetësia kosovare. KQZ pohon se kjo do të thotë se listat janë pastruar²⁶ por ky pastrim është larg nga ajo që duhet të ndodhë.

Ndërkohë janë shtuar 140,000 votues të rinj për tri vite²⁷, përderisa shtimi natyror (nataliteti minus vdekshmëria minus migracioni) mund të shpjegojnë vetëm rreth 15,000 për vit. Është e qartë se nuk është përmbushur pika 7 përderisa pika 14 duhet të presë vazhdimin e reformës pas zgjedhjeve.

Është inkurajuese që ka gatishmëri për të publikuar listën e votuesve më herët se zakonisht, gjithashtu një kërkesë e shoqërisë civile pranë Forumit Reforma. Vërehet se të gjithë kanë votuar pro, por kjo do të varet nga kapacitetet e KQZ-së dhe saktësia e regjistrit civil që mirëmbahet nga Regjistri Civil pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Koha e publikimit të listave për verifikim	Shpallja së paku 120 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe mbyllja 45 ditë para ditës së zgjedhjeve	JO	X*	X	X		X	X	X	X	
	Siç është aktualisht	JO									

* PDK-së i duhen ende konsultime!

Do të ishte edhe më pozitive nëse përcjellen këshillat e Komisionit të Venedikut që lista e votuesve të jetë publike gjatë gjithë kohës.²⁸ Nëse kërkesa e BE-së nënkupton amendamentin e Komisionit për reformë zgjedhore atëherë efekti i një vendimi të tillë do të ishte pozitiv sa i përket pastrimit të listës votuese ku sipas KQZ-s do të largoheshim rreth 318,521 emra nga lista votuese që posedojnë vetëm dokumente të UNMIK-ut dhe nuk kanë aplikuar për dokumente të Kosovës²⁹. Këtij numri duhet shtuar edhe një numer votuesish nga komunat veriore të Kosovës të cilet posedojnë vetëm dokumentet e Republikës së Serbisë.

Vota me kusht dhe me postë

Liderët së paku janë pajtuar se duhet hequr votën me kusht.

Kjo përkon me rekomandimet e bashkësisë ndërkombëtare si dhe votën me postë për zgjedhjet lokale, në pajtim me rekomandimet e shoqërisë civile.

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Votat me kusht	Siç është aktualisht	JO									
	Eliminimi i votës me kusht	JO	X	X	X		X	X	X	X	X

BE deklaron se duhet

Eliminuar votimin me kusht për të gjitha zgjedhjet sepse parashih keqpërdorim potencial dhe aktivitete manipulative e gjithashtu duhet eliminuar votimin nga qytetarët jashtë vendit për zgjedhjet lokale³⁰

Duhet theksuar se heqja përfundimtare e votës me kusht varet nga pastrimi i listës votuese si dhe caktimi i saktë i votuesve nëpër vendvotimet e tyre më të afërta. Sfidë e veçantë mbetet mirëmbajtja e adresave të sakta për votuesit gjë e cila për momentin gati se nuk ekziston fare. Nëse nuk rregullohet lista votuese, atëherë eliminimi i votës me kusht mund të privojë shumë votues nga e drejta e votës që është garantohet me kushtetutë. Si rezultat, përkundër deklaratave të liderëve, shumë lehtë mund të shohim rikthimin e votës me kusht.

Votimi i diasporës

Pjesëmarrja në zgjedhjet lokale nga votuesit jashtë vendit është shumë e ulët. Procedurat e komplikuar të aplikimit dhe të votimit për votuesit jashtë vendit është një ndër arsyet e pjesëmarrjes së ulët të diasporës në zgjedhje. Një arsye tjetër duket se është edhe fakti se diaspora më shumë është e koncentruar për të marrë pjesë në jetën politike lokale aty ku paguan tatimet rregullisht (në vendin ku ka migruar) sesa në komunën e vendlindjes.

Manipulimet zgjedhore kanë ndikuar gjithashtu në pjesëmarrjen e ulët të diasporës në votime. Pritjet e mëdha të diasporës për ndryshime në Kosovë, dhe krahasimi me vendet perendimore ku jetojnë rezulton me zhgënjim të tyre

dhe rrjedhimisht humbje të interesit për të votuar. Faktor tjetër është edhe integrimi çdo ditë e më shumë i diasporës në shtetet ku jetojnë dhe veprojnë.

Rritja e votimit nga diaspora në zgjedhje edhe më tutje do të mbetet një sfidë që partitë politike nuk po mund ti japin përgjigjen e duhur. Deri tani votimi me postë është treguar i pasuksesshëm nëse marrim parasysh numrin e madh të diasporës me të drejtë vote kundrejt numrit të vogël të atyre që aplikojnë për të votuar (2,000- 3,000) dhe numrit edhe më të vogël të atyre që në fakto votojnë (1,500).

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Mënyrat e votimit nga diaspora	Në ambasada dhe konsullata	JO	*	X	X		X	X	X	X	
	Elektronike	JO	*				X	X	X		
	Ambasada dhe konsull. të shteteve mike	JO	*	X	X		X	X	X	X	

* PDK-së i nevojiten konsultime shitesë!

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
*Votimi me postë		JO	X	X	X		X	X	X	X	X

* Për votimin me postë ka konsensus nga të gjitha partitë!

Forumi i liderëve u shpreh hapur për të gjitha mënyrat e votimit (si me poshtë ashtu edhe nëpër përfaqësi diplomatike), por kjo mbetet më tepër listë e dëshirave sesa një shprehje konkrete që mund të realizohet së shpejti.

D4D përkrah idetë për futjen e metodave të reja për votim për diasporën duke përfshirë votimin fizik nëpër ambasada dhe konsullata të Republikës së Kosovës. Gjithashtu listat votuese duhet të jenë të veçanta dhe emrat e votuesve nga diaspora nuk duhet të figurojnë në fshatrat prej nga vijnë. Krijimi i LV-së së veçantë krijon mundësi më të madhe për votim nga diaspora dhe eliminon mundësinë e keqpërdorimit me emrave të tyre.

Diaspora kosovare me banim të përhershëm jashtë vendit duhet të ruajë të drejtën e votës për zgjedhje kombëtare, por jo edhe për ato komunale. Zgjedhja e përfaqësuesve lokal duhet të jetë e drejtë e vetëm atyre personave që jetojnë në atë komunë së paku 6 muaj para se të mbahen zgjedhjet.

Dokumentet e pranueshme për të votuar

Kosova ende nuk ka mundur të vendosë se me çfarë dokumente votuesit mund të votojnë në zgjedhjet e organizuara nga Republika e Kosovës. Neni 90 i LZP-së tregon se me cilat dokumente mund të votohet, por lejon hapësirë për interpretime se të cilit shtet mund të jenë këto dokumente.

- (a) letërnjoftimi i vlefshëm;
- (b) pasaporta valide;
- (c) dokumenti i vlefshëm i udhëtimit;
- (d) leja e vozitjes e vlefshëm e Kosovës;
- (e) kartela e vlefshme e PZHBV-ve; ose
- (f) kartela e vlefshme e refugjatit³¹

Ky nen nuk duket mjaft i qartë pasi që BE-ja kërkon që të

sqarohet se cilat dokumente janë të pranueshme për të votuar³²

Komisioni për reformë zgjedhore ka përfshirë amendamentin ku me ligj përcaktohet se mund të votohet vetëm me dokumente të Republikës së Kosovës. Forumi Reforma dhe D4D ka rekomanduar që dokumente të pranueshme të jenë vetëm dokumentet e Kosovës duke pasur parasysh që ka kaluar kohë e gjatë që nga shpallja e pavarësisë dhe se qytetarët kanë mundur të pajisen me dokumente të saj. Gjithashtu marrëveshja e fundit mes Kosovës dhe Serbisë ka hapur rrugë që në Kosovë të votohet vetëm me dokumente të Republikës së Kosovës.

Negociatat me Serbinë kanë lejuar që serbët e veriut të mund të votojnë me dokumente tjera përveç atyre të Kosovës dhe kjo mund të arsyetohet për një palë zgjedhje në shkëmbim me integrimin e veriut. Por, pas zgjedhjeve lokale, Kosova duhet të qartësojë që tutje do të mund të votohet vetëm me dokumente të Republikës së Kosovës dhe kjo të aplikohet për zgjedhjet kombëtare të vitit 2014. Zgjedhjet nuk mund të ruhen nëse lihet boshllëku ligjor i cili

mund të keqpërdoret.

Çështja nuk qëndron vetëm tek dokumentet personale dhe tek simbolika shtetërore, por ata që nuk kanë marrë dokumente të Kosovës, nuk kanë numër personal dhe si të tillë nuk mund të përfshihen as në listë të votuesve. Regjistrimi në listë të votuesve të personave që nuk kanë fare shtetësi të Kosovës hap rrugën edhe për emra të dyfishtë dhe vështirëson pastrimin e listave.

Procesi zgjedhor

Kohëzgjatja e fushatës

Shkurtimi i fushatës zgjedhore ka gëzuar përkrahjen e të gjitha partive politike me përjashtim të VV.

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Kohëzgjatja e fushatës	14 ditë	JO	X	X			X	X	X	X	
	21 ditë	JO									
	31 ditë	JO			X						

Një fushatë më e shkurtër parazgjedhore do të ketë ndikim negativ për shpалosjen e programeve të partive politike e sidomos të partive opozitare dhe partive të vogla. Përderisa partitë në pushtet kanë pasur mandat të plotë prej katër viteve të tregojnë performancën, fushata është rast edhe për opozitën të tregojë se çfarë planifikon të bëjë. Vetëm gjatë fushatës zyrtare, opozita e ka të garantuar eksponimin medial dhe shkurtimi i saj kufizon mundësitë e opozitës për të garuar me vizionet e tyre.

Shkurtimi i fushatës gjithashtu mund të rrisë tensionet sepse rritet konkurrenca për qasje në hapësira adekuate për të zhvilluar fushatë. Kërkesat e shumta për shfrytëzimin mund të sjellin në konflikt dhe do të favorizojnë partitë kryesore.

Identifikimi dhe shenjimi i votuesve

Që nga zgjedhjet e para të pasluftës identifikimi i votuesve është bërë në mënyrë manuale. Për zgjedhjet e viteve të fundit 2009 dhe 2010 është shënuar një hap prapa sepse është hequr fotografia e votuesit nga lista që kishte qenë në zgjedhjet e mëhershme. Me përjashtim të PDK-s, partitë tjera politike përkrahin propozimin për identifikim dual, biometrik dhe manual.

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Identifikimi	Siç është aktualisht (manual)	JO	*								
Identifikimi	Biometrik + manual	JO	*	X	X		X	X	X	X	

* PDK-së i nevojiten konsultime shtesë!

Kjo është gjithashtu një dëshirë e mirë, por që nuk merr parasysh realitetin dhe mundësitë. Disa konsulentë kanë këshilluar anëterët e Komisionit për reformë zgjedhore se identifikimi biometrik është tejet e vështirë të realizohet. Por sërish në pamundësi për të parandaluar votimin e shumëfishtë, shpresat vihen në një zgjedhje gati si me magji apo së paku për të shfajësuar veten se kinse është bërë maksimumi. Opozita duhet të këshillohet si të sigurohet identifikimi i sigurtë pa teknologji të lartë sepse duke mbajtur shpresë në super-zgjidhje teknike, shpenzohet kohë e vlefshme dhe në fund identifikimi do të mbetet i mangët si më parë.

Një nga mënyrat që mundëson votimin e shumëfishtë ka qenë cilësia e dobët e ngjyrës “së padukshme” si dhe mosfunksioni i llambave UV. Komisioni Evropian gjithashtu e ka identifikuar këtë problem dhe ka propozuar që

Ngjyra e padukshme të zëvendësohet me ngjyrë të dukshme³³.

Forumi Reforma dhe D4D më herët ka propozar që ngjyra e padukshme dhe llambat të mbesin të paketuara nga prodhuesi deri në momentin kur i dorëzohen qendrës së votimit, por del se edhe kjo nuk ofron garanci të mjaftueshme.

Propozimi i BE-së mund të duket radikal dhe në një mënyrë edhe fyes (ngjyra e dukshme përdoret kryesisht në vende me demokraci fillestare dhe vende postkonfliktuale) por praktika dhe problemet e shfaqura nga zgjedhjet e kaluara nuk ka lënë hapësirë që të na mbetet hatri.

Teknologjia u sugjerua edhe si ilaç për procesin e votimit por kjo fitoi vetëm përkrahjen e AKR-së. Shumica ishin të mendimit se votimi duhet të vazhdojë në mënyrë manuale ashtu edhe si deri më tani.

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Votimi	Siç është aktualisht(manual)	JO	X	X	X		X	X	X	X
	Elektronik	JO								
	Elektronik+ manual	JO				X*				

* AKR propozon variantin e tretë por ofron konsensus edhe për variantin e parë!

Përkundër përparimit të teknologjise dhe mundësive për të përdorur forma të ndryshme të votimit elektronik edhe D4D mendon se votimi manual është mënyra e duhur për të votuar. Votimi elektronik do të ishte i rrëzikshëm për shkak të mundësisë së abuzimit softuerik, dështimit të elektronikës në ditën e zgjedhjeve si dhe pamundësisë së një auditimi nëse do të ishte e nevojshme.

Numërimi dhe drejtësia zgjedhore

Vendi dhe mënyra e numërimit të votave

Përkundër sugjerimeve të BE-së, partitë politike kanë përkrahur idenë që numërimi i votave të bëhet në një qendër në çdo komunë.

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Vendi i numërimit të votave	Në vendvotim	JO								
	Një qendër numerimi për komunë	JO	X	X	X		X	X	X	X
	Një qendër numerimi për qendër votimi	JO								

BE sugjeron të kundërtën:

Të vazhdohet praktika e numërimit nëpër vendvotime dhe jo të centralizohet [Komisioni i Venecias: votat preferohet që të numërohen nëpër vendvotime [...] pasi që ulë rrezikun e zëvendësimit]³⁴.

Edhe brenda shoqërisë civile ka mendime të ndara sa i përket kësaj çështje. Përkrahësit e numërimit të votave në vendvotime theksojnë mundësinë e ndërrimit të kutive të votimit por edhe vonesat që do të shkaktoheshin me numërimin dhe shpalljen e rezultateve.

Raporti i progresit kishte kritikuar vonesat si një nga shkaktarët e humbjes së besimit në zgjedhje.

Përsëritja e zgjedhjeve, rinumërimi dhe vonesat në publikimin e rezultateve kanë dëmtuar kredibilitetin e procesit dhe legjitimitetin e rezultateve.³⁵

Përkrahësit e numërimit në një qendër votimi për secilën komunë theksojnë praktiken e keqe të deritanishme ku komisionarët në vendvotime kanë bërë manipulimet më të mëdha të mundshme sidomos gjatë fazës së numërimit.

Numërimi në një qendër do të mundësonte numërim transparent, para një numri të madhe mediesh, vëzhguesish dhe do të mund të përdorej edhe skaneri/kamerat dhe e tërë kjo do të reduktonte manipulimet e mundshme në minimum. E meta e numërimit në një qendër votimi mbetet

mundësia e ndërrimit të kutive të votimit si pamundësia e auditit dhe mungesa e sigurisë nëse kutia e numëruar ka qenë kutia me votat e vërteta.

Me përjashtim të PDK-së, forumi i liderëve gjithashtu u pajtua që votat të numërohen në mënyrë fizike dhe elektronike.

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Mënyra e numërimit	Fizik dhe elektronik	JO	*	X	X		X	X	X	X
	Fizik (siç është aktualisht)	JO	*							

* PDK-së i duhen ende konsultime!

Diskutimi i mangët dhe vendimi i shpejtë në parim zbulon që opinionet janë bërë pa diskutim të detajshëm që është e domosdoshme për një temë teknike si kjo. D4D përkrah përdorimin e teknologjisë për numërim, por kjo mund të shqyrtohet vetëm nëse me të vërtetë centralizohet numërimi në qendra rajonale.

Rezultatet

Publikimi i shpejtë i rezultateve ndikon në uljen e tensionit në mbrëmjen e zgjedhjeve. Rezultatet e zgjedhjeve tona shpesh janë vonuar me javë të tëra që kanë ngritur dyshimet për manipulime si te partitë politike ashtu edhe te elektorati. Një dukuri tjetër që ndikon në ngritjen e mosbesimit në rezultatet e paraqitura është edhe mosdhënia e një kopje të rezultateve nga vendvotimet partive si dhe të gjithë vëzhguesve në ato vendvotime. Këto probleme i kanë vërejtur edhe përfaqësuesit e BE dhe kanë propozuar që

Të ketë një afat të caktuar për shpalljen e rezultateve si dhe këto të postohen edhe në ueb faqen e KQZ-së³⁶

Gjithashtu BE kërkon që një

kopje e rezultateve nga vendvotimet t'iu dorëzohet të gjitha palëve të interesuara në vendvotime nëse ata kërkojnë një gjë të tillë.³⁷

Ueb faqja e KQZ-së ka probleme serioze dhe krijon

përshtypjen se më tepër fshesh se sa që zbulon. Kohëve të fundit, KQZ ka përmirësuar faqen por mungojnë shumë informata që do të duhej të ishin publike. Një institucion me të vërtetë i hapur nuk u reziston kërkesave për qasje publike në dokumenta zyrtare, por i bën ato të qasshme për të gjithë.

Drejhtësia zgjedhore

Kërkesa e KE për heqjen e dënimeve kolektive ka gjetur përkrahjen edhe të subjekteve politike që është përfshirë në draft ligjin e ri të papërfunduar. Mbetet e paqartë për një pjesë të opinionit se çfarë mendohet me dënime kolektive kur dihet që subjektet politike janë në të njëjtën kohë edhe subjekte juridike. D4D rekomandon heqjen e dënimeve kolektive por duhet gjetur mënyrë për të kërkuar llogari zinxhirore nga krerët e partive politike. Kjo nuk ka të bëjë me dënim kolektiv por më përgjegjësi hierarkike dhe zinxhirore kur manipulimet planifikohen nga lartë.

BE kërkon që të bëhet më transparent procesi i ankesave dhe parashtresave për të cilat gjithashtu duhet të zgjatet afati.³⁸

Më herët, edhe raporti i EU EEM kishte raportuar se gjykatat nuk zhvillojnë procese transparent dhe se

afati prej 24 orëve për dorëzimin e ankesave mund të jetë shumë i shkurtë për partitë, kandidatët dhe vëzhguesit për të përgatitur ankesa dhe apele të besueshme³⁹.

Në përgjithësi zgjatja e afatit për ankesa ka gjetur mbështetje te komisioni për reformë zgjedhore por duket se nuk ka qenë fare pjesë e agjendës së forumit të liderëve.

Gjykatat të ngadalshme dhe jofunksionale

Që nga paraqitja e rasteve të manipuluesve të zgjedhjeve të vitit 2010 në gjykata e deri të dënimi apo mos dënimi i tyre ka kaluar një kohë e gjatë. Shumë raste ende nuk kanë përfunduar përderisa vendi hyn në një cikël të ri zgjedhor.

Që situata është e keqe në këtë drejtim tregon vetë e dhëna në memon e BE-së ku tregon se më pak se gjysma e 232 rasteve nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010 janë gjykuar deri në shkurt të vitit 2013.⁴⁰

Puna e ngadalshme e gjykatave është bërë çështje që e ka ngritur edhe shkresa e BE-së, duke kërkuar “gjykimin e të gjitha rasteve të dyshuara për mashtrim zgjedhor”⁴¹ si dhe “dënimin e autorëve të krimeve pa vonesë.”⁴² Duke vërejtur shqiptimin e dënimeve më të ulëta nga gjykatësit sesa që parashihet me ligj, dokumenti gjithashtu ka kërkuar që të aplikohen dënimet përkatëse.⁴³

Gjykatat duhet të përmirësojnë punën e tyre dhe të dëshmojnë se janë të pavarura. Që rastet të përfundojnë më shpejtë, të jenë më transparent, duhet të sigurohet aplikimi i dënimeve meritorë në bazë të vepres së kryer. Për shkak të urgjencës që krimet zgjedhore të trajtohen shpejtë gjatë periudhës zgjedhore, ato duhet të jenë prioritet për gjykatat.

Edhe KQZ-ja duhet të jetë më aktive në përcjelljen e manipulimeve sepse kjo rëndon në imazhin e zgjedhjeve dhe të vetë KQZ-së. Vetë KQZ nuk ka përdorur të gjitha mjetet juridike që ka pasur në dispozicion. Siç gjen Instituti Kosovar i Drejtësisë,

Përkundër udhëzimeve të gjykatave që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të ushtroj padi civile për kompensim, një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur⁴⁴.

KQZ-ja duhet të jetë më transparente dhe të raportojë nëse ka ngritur padi civile sipas udhëzimeve të gjykatave, dhe nëse jo atëherë duhet të marrë përgjegjësi se pse kjo gjë nuk është bërë. KQZ gjithashtu duhet të raportojë statistikën e të gjitha llojeve të shkeljeve që janë raportuar tek institucionet vartëse të saj (nga KVV-të e deri tek Qendra e Numërimit).

Një shembull i tillë ka ndodhur në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Ferizaj me 2012. Tetë persona ishin raportuar se kanë votuar edhe me

kusht edhe në mënyrë të rregullt. KQZ në atë mbledhje vendosi që këto raste t'i procedojë tutje në prokurori por sipas informatave të D4D-së deri me datën 23 korrik 2013 një gjë e tillë nuk ka ndodhur⁴⁵. Në këtë rast KQZ-ja jo vetëm që nuk ndërmori masa ndaj manipuluesve potencial të zgjedhjeve por me heshtjen zgjodhi të amnistojë shkelësit e dyshuar.

Përtej reformës elektorale

Disa nga rekomandimet kanë të bëjnë me zgjedhjet por jo drejtpërdrejtë. Shkresa e BE-së kërkon që të garantohet qasje në mediat publike.⁴⁶ Fakti se BE ngrit lirinë e medimeve publike është brengosëse dhe duhet të merret me seriozitet. BE ngrit edhe dy tema tjera, financimi dhe regjistrimi i partive politike.

Financimi i Partive politike

Edhe pse i rregulluar me ligj dhe me rregullore të KQZ-së, rregullimi i financimit të partive politike ka mangësi serioze. Në shkresën dërguar partive politike, BE kërkon

Të amandamentohet dhe të implementohet në tërësi ligji për financimin e partive politike që në mënyrë strikte të rregullon rregullat e donacionit dhe të sqarojë obligimet e partive politike për të raportuar⁴⁷.

Për më shumë ky dokument thirret edhe në raportin e Komisionit Evropian për liberalizim të vizave ku kërkohet transparencë në financimin e partive politike⁴⁸ si një ndër masat efektive për të luftuar korrupsionin dhe si masë parandaluese ndaj korrupsionit.

Një studim për financat e partive politike konkludon se korniza ligjore nuk është në linjë me standardet evropiane sepse ajo as nuk e ndalon dhe as nuk i rregullon në mënyrë strikte donacionet nga entitetet legale, dhe rekomandon që ky ligj duhet “të obligojë partitë të kenë kenë vetëm një xhironlogari bankare dhe të vendosë afate strikte në lidhje me publikimin e raportëve financiare”⁴⁹.

Mungesa e një ligji të ashpër që skanon prejardhjen e donacioneve lidhet drejtpërdrejtë me barazinë e garës zgjedhore dhe me mundësinë e sistemit të patronazhit për të përdorur shërbimin civil dhe buxhetin shtetëror për nevoja të partisë.

Regjistrimi i partive politike

Partitë politike ekzistuese kanë pushtet të theksuar edhe në regjistrim të partive të reja, sepse ky proces bëhet nga Zyra për regjistrimin e partive politike që është pjesë e Sekretariatit dhe vendimmarrja përfundimtare është e KQZ-së (dtth e partive më të mëdha ekzistuese). Kjo paraqet konflikt interesi që është ngjashëm edhe me fuqinë e KQZ-së për të ngritur pragun që subjektet e reja duhet të tejkalojnë për të hyrë në garë (numri i nënshkrimeve dhe pagesa).

Shkresa e BE-së kërkon që

Urgjentisht të rriten resurset e Zyres për regjistrimin dhe certifikimin e partive politike⁵⁰

Shoqëria civile ka kërkuar që regjistrimi i partive politike të mos bëhet nga KQZ-ja politike por pranë një trupi të gjyqësorit.

Konkluzionet

Përfshirja në politikë derivon përfitime marramendëse në Kosovë. Investimi i partive dhe i individëve kthehet shumëfish pas zgjedhjes. Kjo logjikë e “fitimtarit që merr të gjithat” rrit motivin që me çdo kusht të fitohen zgjedhjet. Por nuk janë të paktë ata që kanë theksuar se nëse përsëriten shkeljet e vitit 2010 vendi ynë mund të rrëshqasë drejt dhunës politike.

Gabimet nga viti 2010 duhet parandaluar dhe kjo do të ndodh vetëm nëse ndërtohet vullnet politik për të vendosur vendin para interesit individual partiak. Krahas pritjes për ndërgjegje është e kotë, duhet ndërmarrë reformë ligjore për të ngushtuar hapësirën për manipulime. Presioni i shoqërisë civile dhe i bashkësisë ndërkombëtare mund të shtyjë të dy aspektet përpara. Hallka e fundit që e përmbyll këtë proces janë gjykatat të cilat duhet të shqiptojnë dënime të cilat vërtetë dekurajojnë shkeljet.

Zgjedhjet me integritet janë mënyra kryesore që të përkthejmë besimin e qytetarëve në vendimmarrje. Që politika t'i shërbejë qytetarit dhe jo anasjelltas, duhet rikthyer ambiciet për reformën zgjedhore. Vetëm duke shuar industrinë e manipulimeve zgjedhore, vendi mund të nxisë industri zhvillimore gjetiu.

Konkluzionet e Forumit Reforma

Shumica e rekomandimeve të këtij punimi janë përfshirë në pjesët e veçanta ndërsa me poshtë janë rekomandimet e Forumit Reforma dhe të D4D-së.

Për zgjedhjen e drejtpërdrejtë për presidentin e vendit

<http://d4d-ks.org/aktivitetet/rekomandimet-e-forumit-reforma-per-zgjedhjen-e-presidentit-te-kosoves/>

Për KQZ-në

<http://d4d-ks.org/aktivitetet/rekomandimet-e-forumit-reforma-per-strukturen-e-kqz-se/>

Për sistemin zgjedhor:

<http://d4d-ks.org/aktivitetet/rekomandimet-e-forumit-reforma-per-sistemin-zgjedhor/>

Për listën votuese

<http://d4d-ks.org/aktivitetet/rekomandimet-e-forumit-reforma-per-riparim-te-listes-se-votuesve/>

Aneksi I: Rezoluta e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV Kuvendi

Në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 52. 2 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 7 prill 2011, pas shqyrtimit të propozimeve të grupeve parlamentare të PDK-së, LDK-së dhe AKR-së, nxori këtë:

REZOLUTË

Në mbështetje të Memorandimit të Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh përkrahjen e tij për Memorandumin e Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi (më tej Memorandumi), të arritur më 6 prill 2011, dhe mbështetë plotësisht zotimet e përmbajtura në të.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështetë zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum që kanë të bëjnë me nevojën për amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit të ndërlidhur në mënyrë që presidenti i Republikës së Kosovës të zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Kuvendi mbështetë afatin kohor të përmbajtur në Memorandum sipas të cilit zgjedhjet e para presidenciale në Kosovë do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe legjislative hyjnë në fuqi. Kuvendi mbështetë themelimin e një komisioni, të udhëhequr nga një deputet i Kuvendit i identifikuar nga koalicioni qeverisës, për këtë qëllim ashtu siç është paraparë në Memorandum. Në pajtueshmëri me Memorandumin, Komisioni do të synojë të kryejë punën e vet brenda 6-9 muajsh nga data e themelimit.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështetë zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum që kanë të bëjnë me nevojën për amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe legjislacionit të ndërlidhur, që mes tjerash do të përkrahin krijimin e më shumë distrikteve zgjedhore në Kosovë. Kuvendi mbështetë themelimin e një komisioni, të udhëhequr nga një deputet i Kuvendit i identifikuar nga partitë opozitare, për këtë qëllim ashtu siç është paraparë në

Deforma zgjedhore

Memorandum. Në pajtueshmëri me Memorandumin, Komisioni do të synojë të kryejë punën e vet brenda 8-12 muajsh nga data e themelimit.

4. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështetë afatin kohor të përmbajtur në Memorandum sipas të cilit zgjedhjet e para të përgjithshme në Kosovë sipas Ligjit të amandamentuar për Zgjedhjet e Përgjithshme do të mbahen jo më vonë se 18 muaj nga data e hyrjes në fuqi të tij.
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështetë themelimin e komisioneve të lartpërmendura, të nevojshme për proceset kushtetuese dhe legjislativë në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Nr. 04 - R -01^{At}
Prishtinë, më 7 prill 2011

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Rezoluta i dërgohet:

- Presidentes së Kosovës,
- Grupeve Parlamentare,
- Qeverisë së Kosovës,
- Arkivit të Kuvendit.

Aneksi II: Marrëveshja politike

Memorandum i Marrëveshjes Ndërmjet

Z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi

1. Ne, udhëheqësit e AKR-së, LDK-së dhe PDK-së, nominojmë Atifete Jahjagën si kandidate tonën për presidente të Republikës së Kosovës dhe shprehim përkrahjen e plotë të partive tona respektive për kandidaturën e saj. Jemi të përkushtuar ta vemë interesin e vendit mbi atë tonin.
2. Ne pajtohemi që menjëherë të formojmë një “Komision për Reformën e Zgjedhjeve Presidenciale” që do të hartojë amandamentet e nevojshme kushtetuese dhe çfarëdo legjislacioni të ndërlidhur, të nevojshëm për të amendamentuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës në mënyrë që presidenti të zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Komisioni do të synojë të përfundojë punën e vet brenda 6 - 9 muajsh nga data e themelimit të tij. Një anëtar i Kuvendit i identifikuar nga koalicioni qeverisës do të udhëheqë Komisionin e themeluar për këtë qëllim. Ne pajtohemi se zgjedhjet e para të drejtpërdrejta presidenciale në Kosovë do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe legjislative hyjnë në fuqi.
3. Ne pajtohemi që menjëherë të formojmë një “Komision për Reformën e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme”, i cili, mes dispozitave tjera, do të përkrahë krijimin e më shumë distrikteve zgjedhore në Kosovë dhe do të hartojë ndryshimet e nevojshme legjislative dhe kushtetuese për ta arritur këtë qëllim. Komisioni do të synojë të përfundojë punën e vet brenda 8 - 12 muajsh nga data e themelimit të tij. Një anëtar i Kuvendit i identifikuar nga partitë opozitare do të udhëheqë Komisionin e themeluar për këtë qëllim.
4. Ne pajtohemi se Ligji i reformuar për Zgjedhjet e Përgjithshme do të përfshijë një dispozitë që thotë se zgjedhjet e para të përgjithshme sipas ligjit të amendamentuar do të mbahen jo më vonë se 18 muaj nga data në të cilën Ligji i reformuar për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe amandamentet e ndërlidhura kushtetuese hyjnë në fuqi.
5. Ne, po ashtu, pajtohemi se si pjesë e kësaj marrëveshjeje, do të paraqesim ndryshimet e përmendura në paragrafet 2, 3 dhe 4 në mbledhjen e Kuvendit në të cilën zgjedhet presidenti i Kosovës.

Nënshkruar nga

Behgjet Pacolli

Isa Mustafa

Hashim Thaçi

Dëshmuar nga:

Christopher Dell

Prishtinë

6 prill 2011

Aneksi III: Letra e BE-së

Memorandum dërguar Lidereve të Partive për Procesin e Reformës Zgjedhore në Kosove nga Përfaqësuesi i Lartë i Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë.

Parimet e përgjithshme për reformën zgjedhore:

1. Të përfundojnë diskutimet mes lidereve partiak duke mos pasur shtyerje tjera, duke përfshirë edhe shoqërinë civile dhe aktorët tjerë relevant dhe të përfundojnë diskutimet në Parlament duke adaptuar ndryshimet e nevojshme.¹
2. Reforma të ofroj zgjedhje të lira, fer dhe demokratike.
3. Të prodhojë një reformë që forcon thjeshtësinë dhe transparencën e legjislacionit zgjedhor.²
4. Të sigurojë një përfaqësim të forte dhe jetëgjatë të komuniteteve pakicë, mundësisht përmes zgjatjes të sistemit të ulësve të rezervuara ose në një formë tjetër që është në linjë me standardet ndërkombëtare.³
5. Të ruhet përfaqësimi gjinor.
6. Të garantohet qasja e lirë në skemen programore të mediave publike.
7. Listat votuese të rregullohen/pastrohen së paku 3 muaj para zgjedhjeve.
8. Zgjedhjet Lokale 2013 të mbahen në afatin e paraparë ligjor. Data për zgjedhje: jo më parë se 22/09/2013 dhe jo më vonë se 15/12/2013; të vendoset data që Presidenti të vendos datën: jo më parë se 22/03/2013 dhe jo më vonë 15/08/2013].⁴
9. Lideret politik duhet të shprehin vendosmërinë e tyre dhe angazhimin për të mos lejuar parregullësi si në zgjedhjet e 2010-ës
10. Të kërkohen mundësitë së bashku me Këshillin e Evropës që të zbarkoi një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në rastin e zgjedhjeve lokale 2013.

¹ Menjëherëz pasi të përfundohet rishikimi i Ligjit për Zgjedhjet e përgjithshme, kërkohet harmonizimi me Ligjin për Zgjedhjet Lokale dhe me legjislacionin dytësor. Për shkak të afatit të shkurtër kohor, zgjedhjet lokale 2013 duhet të mbahen sipas legjislacionit në fuqi, duke marr parasysh Kodin e Komisionit të Venecias për Praktikën e Mira në Çështjet Zgjedhore, pika II.2.b: "Elementetet bazike të ligjit zgjedhor, në veçanti vetë sistemi zgjedhor, anëtarët e komisioneve zgjedhore dhe rishikimi i kufijve të zonave zgjedhore, nuk duhet të jenë të hapura për amendamente më pak se një vit para zgjedhjeve."

² Komisioni Evropian për Demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venecias), 9 tetor 2002, Kodi i Praktikës së mirë në çështjet zgjedhore konstaton "Rregullat të cilat ndryshojnë shpesh – dhe veçanërisht rregullat të cilat janë të komplikuar – mund t'i bëjnë konfuz votuesit" dhe më tej "praktikat ndërkombëtare kryesisht ofrojnë procedura të thjeshta votimi".

³ "Rregull të e veçanta të cilat garantojnë vendet e rezervuara për minoritetet kombëtare ose përjashtimi nga kriterët për ndarjen normale të ulësve për partitë që përfaqësojnë minoritetet kombëtare (p.sh.: përjashtimi nga kriteri i kuorumit) nuk është në kundërshtim me votimin e barabartë" Opinioni i Komisionit të Venecias no. 190/2002"

⁴ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Neni 21 vendos pesë parime themelore të demokracisë zgjedhore: ligjshmërinë, periudhën (periodicitetin), votimi i fshehtë dhe votimi universal dhe i barabartë.

Për tu përmbushur këto parime të përgjithshme, dhe pika 4 në veçanti, duhet marr në konsideratë opsionet e mëposhtme:

- Të reduktohet në minimum numri i votave preferenciale. Do të ishte më mirë që votuesi të shpreh një preferencë të vetme për kandidatin që ai zgjedh. Kjo do të mundësonte numërimin më të shpejtë nga trupat e menaxhimit të zgjedhjeve dhe të reduktojë mundësinë për mashtrime brenda partive.
- Të specifikohet se pragu zgjedhor nuk vlen për partitë që përfaqësojnë komunitetet pakicë.
- Për të gjitha zgjedhjet të hiqet votimi me kusht, pasi kjo mund të çojë në keqpërdorim dhe veprime mashtruese, poashtu të hiqet edhe votimi nga jashtë vendi për zgjedhjet lokale.
- Të qartësohet cilat dokumente janë të pranueshme për votim.
- Të zëvendësohet ngjyra e padukshme me ngjyrë të dukshme.
- Të hiqen sanksionet kolektive.
- Procesi i ankesave dhe apeleve të bëhet më transparent duke i bërë të gjitha ankesat publike dhe procesi i rishikimit të jetë i hapur për publik. Të zgjatet afati për ankesa dhe parashtrësia, siç është rekomanduar nga Komisioni për Reformë Zgjedhore.
- Të vazhdohet praktika e numërimit nëpër qendra të votimit dhe jo në lokacionin qendror [Komisioni i Venecias: Votat duhet të numërohen në vendvotime] [...] pasi kjo ulë rrezikun për zëvendësim/ndërrimim (V.A. e kutive, fletëvotimeve).
- Të caktohet një afat për shpalljen e rezultateve finale dhe të publikohen të gjitha informacionet brenda një kohe të arsyeshme në ueb-faqen e KQZ-së.
- Të ofrohen kopjet e vërtetuara të formularit të rezultateve dhe përputhjes së rezultateve për të gjithë përfaqësuesit e partive dhe vëzhguesve tjerë sipas kërkesës së tyre.

PAS REFORMËS ZGJEDHORE

- 11. Të amandamentohet dhe të implementohet në tërësi Ligji për financimin e partive politike për të rregulluar në mënyrë strikte rregullat e donacioneve dhe të qartësohet obligimet e raportimit të partive politike.** Kjo gjithashtu është një kërkesë nga raporti i parë në dialogun për Liberalizimin e Vizave pasi që financimi i partive politike konsiderohet si njëri nga fushat më kritike të luftimit të korrupsionit.⁵
- 12. Urgjentisht të rriten resurset e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.**
- 13. Të gjykohej të gjitha rastet e kaluara të dyshimit për mashtrim zgjedhor.** Kryesit e këtyre veprave duhet të sanksionohen brenda kohës së duhur. Të sigurohet që

⁵ Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), 11 shtator 2003, Konventa mbi Standardeve të Zgjedhjeve, Të Drejtat Zgjedhore dhe Liritë kërkon "financim publik, me kohë të zgjedhjeve, fushat zgjedhore të kandidatëve dhe partive politike (koalicioneve), dhe hapjen e informacionit rreth shpenzimeve për përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve ose fushatave zgjedhore të kandidatëve dhe partive politike (koalicioneve)"; "kandidatët dhe partitë politike (koalicionet) që marrin pjesë në zgjedhje, të përcaktuara sipas ligjit, dorëzojnë tek organet dhe zyrtarët të parapara me ligj, informacion dhe raport lidhur me pranimin e të gjitha donacioneve në fondet e tyre zgjedhore, donatorët, dhe të gjitha shpenzimet nga ata prej këtyre fondeve për të financuar fushatën e tyre zgjedhore. Ata gjithashtu duhet të aranzhojnë publikimin e informacioneve dhe raporteve të tilla, përveç nëse kjo detyrë është e imponuar nga ligji mbi organet zgjedhore."

zbatohen sanksionet e duhura [më pak se gjysma 232 raste që rezultojnë nga zgjedhjet e përgjithshme të 2010-ës janë gjykuar deri në shkurt të 2013-ës]

- 14. Të qartësohen kompetencat e autoriteteve në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, duke përfshirë konsolidimin bazës kryesore për të dhënat për popullsinë për të mundësuar një listë më të mirë të votuesve.** *Momentalisht ky proces është duke vazhduar me ndihmën e projektit IPA për mbështetje të Agjencisë së Regjistrimit Civil në kontekst të dialogut për liberalizimin e vizave. Një vëmendje më e madhe politike do të ndihmonte në përshpejtimin e krijimit të një regjistri qendror të popullsisë, në këtë mënyrë do kemi listë të votuesve të përditësuar.*

Aneksi IV: Qëndrimet e liderëve

Raport nga takimi për Reformën zgjedhore - takimi i liderëve partiake
Organizuar nga Aleanca Kosova e Re - 23 Prill 2013



Çështjet për tu vendosur		Ndryshimet kushtetuese	PODK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Zonat zgjedhore	Një zonë zgjedhore	JO	X*	X*	X		X	X	X	X	
	6 zona zgjedhore	JO	X*								
	Një komunë një zonë	JO		X*							
	100 zona zgjedhore	JO									

*PODK është për një zonë ose gjashtë zona zgjedhore!

*LDK është për një zonë ose çdo komunë një zonë zgjedhore!

		PODK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Pragu zgjedhor	7% koalicionet	JO	X	X	X		X	X	X	X
	5% partitë politike	JO	X	X	X		X	X	X	X
	2.5% kandidatët e pavarur	JO	X	X	X		X	X	X	X

Konkluzion: Pragu zgjedhor miratohet nga të gjitha partitë politike!

		PODK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Zgjedhja e Presidentit (neni 86)	Nga qytetarët	PO	X*	X		X	X	X	X	
	Nga Kuvendi	JO	X*		X					

*PODK dakordohet për të dy variantet!

		PODK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Përberja e KQZ-së (neni 139)	50% pozita + 50% opozita	PO		X	X					
	70% pozita + 30% opozita	PO								
	Siç është aktualisht	JO	X				X*	X	X	X

*AKR dakordohet për variantin e parë por ofron konsensus edhe për variantin e tretë!

		PODK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Listat	Të hapura	JO	X	X	X		X	X	X	X
	Të mbyllura (neni 64)	PO								

Konkluzion: Të gjitha partitë pajtohen që listat të jenë të hapura!

		PODK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Votimi i listës	Votat e partisë, votë e liderit + 3 persona	JO	X	X			X	X	X	X
	Siç është aktualisht/ + 5 persona	JO			X*					

*VV nuk ofron konsensus!

		PODK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Kohëzgjatja e fushatës	14 ditë	JO	X	X			X	X	X	X
	21 ditë	JO								
	31 ditë	JO		X						

*VV nuk ofron konsensus!

Deforma zgjedhore

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Mënyrat e votimit nga diaspora	Në ambasada dhe konsullata	JO	*	X	X		X	X	X	X	
	Elektronike	JO	*				X	X	X		
	Ambasada dhe konsull. të shteteve mike	JO	*	X	X		X	X	X	X	

* PDK-së i nevojiten konsultime shtesë!

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
*Votimi me postë		JO	X	X	X		X	X	X	X	X

* Për votimin me postë ka konsensus nga të gjitha partitë!

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Deputetët nga diasp.	Plus 5 deputetë	PO	*					*			
	Plus 2 deputetë (në kuadër të 120)	PO	*	X*	X*		X*	*	X	X	

* PDK-së dhe SLS-së i nevojiten konsultime shtesë për mënyrën si votohet, kush voton etj.

* Partitë tjera dakordohen që të ketë dy vende pa u rritur numri prej 120 deputetëve!

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Rritja e numrit të deput. (neni 64)	Nga 120 në 125	PO									
	Nga 120 në 130	PO									
	Siç është aktualisht	PO	X	X	X		X	X	X	X	X

Konkluzion: Miratohet varianti siç është aktualisht!

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Vendet e rezervuara (neni 148)	Vendet e rezervuara + 1 mandat	PO									X
	Vendet e rezervuara + 2 mandate	PO	X				X	X	X		
	1 Vend për malazezë	PO	X				X	X	X	X	
	1 Vend për kroat	PO	X				X	X	X	X	
	Nuk pajtohet per mandatet e rezervuara	PO		X	X						

Konkluzion: Partitë nuk dakordohen për vendet e rezervuara

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Identifikimi i votuesve	Siç është aktualisht (manual)	JO	*								
	Biometrik + manual	JO	*	X	X		X	X	X	X	

* PDK-së i nevojiten konsultime shtesë!

			PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Menaxhimi i qendrave të votimit	Drejtori i shkolllës - menaxher (aktualisht)	JO	*								
	Menaxheri me konkurs	JO	*	X	X		X	X	X	X	

* PDK-së i nevojiten konsultime shtesë!

Dy vite pas, reforma në pikën zero

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Përpunimi i listave të votuesve	KQZ+MPB+Agj. i regjistrimit të popullsisë	JO	*	X	X		X	X	X	X
	Siç është aktualisht	JO	*							

*PDK-së i nevojiten konsultime shtesë!

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Monitorimi i zgjedhjeve	Shoqëria civile + OSBE + BE, etj	JO	X	X	X		X	X	X	X
	Siç është aktualisht	JO								

Konkluzion: Miratohet!

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Koha e publikimit të listave për verifikim	Shpallja së paku 120 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe mbyllja 45 ditë para ditës së zgjedhjeve	JO	X*	X	X		X	X	X	X
	Siç është aktualisht	JO								

* PDK-së i duhen ende konsultimet!

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Vendi i numerimit të votave	Në vendotim	JO								
	Një qendër numerimi për komunë	JO	X	X	X		X	X	X	X
	Një qendër numerimi për qendër votimi	JO								

Konkluzion: Miratohet!

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Mënyra e numërimit	Fizik dhe elektronik	JO	*	X	X		X	X	X	X
	Fizik (siç është aktualisht)	JO	*							

* PDK-së i duhen ende konsultimet!

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Komisionerët	Siç është aktualisht	JO	X	X	X		X	X	X	X
	Edhe nga komunat tjera	JO					X*			

Konkluzion: Miratohet!

*AKR propozon variantin e dytë por ofron konsensus edhe për variantin e parë!

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Votimi	Siç është aktualisht(manual)	JO	X	X	X		X	X	X	X
	Elektronik	JO								
	Elektronik+ manual	JO					X*			

* AKR propozon variantin e tretë por ofron konsensus edhe për variantin e parë!

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Detyrat e komisionit komunal të zgjedh.	Siç është aktual. (me udhëzim të KQZ-se)	JO	X	X			X	X	X	
	Detyrat ti përcaktohen me ligj	JO			X*		X*			

* VV dhe AKR janë për variantin e dytë!

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Posti i fituar me votë të qytetarit	I pamundur. kand. gjatë mandatit, (neni 73)	PO	X				X	X	X	X
	Me rastin e kandidimit jep dorëheqje	PO								
	Siç është aktualisht	JO		X*	X*					

* LDK dhe VV janë për variantin e tretë!

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Deputeti i zgjedhur mund të jetë edhe post ekzekutiv (neni.72)	Siç është aktualisht	PO	X				X	X	X	X
		JO		X*	X*					

* LDK dhe VV janë për variantin e dytë!

		PDK	LDK	VV	AAK	AKR	SLS	KDTP	PD	Miratimi
Votat me kusht	Siç është aktualisht	JO								
	Eliminimi i votës me kusht	JO	X	X	X		X	X	X	X

Konkluzion: Miratohet!

Fusnotat

1 Kuvendi i Kosovës. 6 prill 2011. Rezolutë në mbështetje të memorandumit të marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacollit, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi.

<http://elibraria.org/assets/Rezoluta-Marreveshja.pdf>, faqe 1.

2 Kuvendi i Kosovës. 6 prill 2011. Rezolutë në mbështetje të memorandumit të marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacollit, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi.

<http://elibraria.org/assets/Rezoluta-Marreveshja.pdf>, faqe 2.

3 Kurti, Albin. 21 maj 2013. Fjala e Kurtit në tryezën “Top Mashtrimet Zgjedhore”, të organizuar nga Forumi 2015 dhe D4D, Prishtinë.

4 Kuvendi i Kosovës. 6 prill 2011. Rezolutë në mbështetje të memorandumit të marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacollit, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi.

<http://elibraria.org/assets/Rezoluta-Marreveshja.pdf>, faqe 1.

5 Forum 2015. 21 maj 2013. Tryezë e organizuar nga Forumi 2015 dhe D4D për lansimin e publikimit “Top Problemet Zgjedhore – Qasje praktike për të kthyer besimin në procesin zgjedhor.”

6 PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>.

7 PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 1, faqe 1.

8 PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore

nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 2.

9 PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 8, faqe 1.

10 Forum 2015. 21 maj 2013. Tryezë e organizuar nga Forumi 2015 dhe D4D për lansimin e publikimit “Top Problemet Zgjedhore – Qasje praktike për të kthyer besimin në procesin zgjedhor.”

11 European Union External Action. 13 December 2010. Kosovo: Joint statement by EU HR Ashton and Enlargement Commissioner Fule on elections. http://www.eu-un.europa.eu/articles/en/article_10484_en.htm

12 EU EEM. 25 janar 2011. Raporti final. Misioni i ekspertëve të zgjedhjeve të Bashkimit Evropian. http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/25012012_final_report_eu_eem_kosovo_2010.pdf, p. 45.

13 EU EEM. 25 janar 2011. Raporti final. Misioni i ekspertëve të zgjedhjeve të Bashkimit Evropian. http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/25012012_final_report_eu_eem_kosovo_2010.pdf, p. 6.

14 PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 3.

15 Malazogu, Leon. 2013. Dokument diskutimi per Procesin Elektoral. Prezantuar në tryezën tematike “Drejtësia. Liria dhe Siguria”. Publikuar nga Task Forca për Integritime Evropiane. http://www.mei-ks.net/repository/docs/Discussion_Material_Electoral_Process.p

df, f. 18.

¹⁶ Kuvendi i Kosovës. 2011. Konkluzionet nga faza e parë e procesit të shqyrtimit dhe amendamentimit të Kushtetutës. <http://elibraria.org/assets/Konkluzionet-nga-faza-e-par%C3%AB-e-procesit-t%C3%AB-shqyrtimit-dhe-amandamentimit-t%C3%AB-Kushtetut%C3%ABs.pdf>.

¹⁷ Kuvendi i Kosovës. 15 qershor 2008. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>; Neni 73.

¹⁸ Kuvendi i Kosovës. 15 qershor 2008. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>; Neni 72.

¹⁹ Indeks. 20 maj 2013. PDK mendon ndryshe nga Thaçi. <http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=58897>

²⁰ EU EEM. 25 janar 2011. Raporti final. Misioni i ekspertëve të zgjedhjeve të Bashkimit Evropian. http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/25012012_final_report_eu_eem_kosovo_2010.pdf, f. 6.

²¹ D4D. 2013. Broshurë e forumit Reforma me rekomandime për Reformën Zgjedhore. Instituti Demokraci për Zhvillim. <http://d4d-ks.org/punimet/broshure-e-forumit-reforma-me-rekomandime-per-reformen-zgjedhore/>, pika 11.

Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. 2013. Top problemet zgjedhore: Qasje praktike për të kthyer besimin në procesin zgjedhor. Instituti Demokraci për Zhvillim punuar për Forumin 2015. <http://d4d-ks.org/assets/Top-Problemset-Zgjedhore-ALB.pdf>, f. 16-17.

Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shkurt 2013. Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme: Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik. <http://d4d-ks.org/assets/D4D-Punimi-FerizajKacanik.pdf>, f. 61.

22 PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill

2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 10, faqe 1.

²³ PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 7, faqe 1.

24 PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 14, faqe 2..

²⁵ Buzhala, Besnik. 14 qershor 2013. Lista e votuesve në Kosovë. [Prezantuar nga autori në tryezë të rrumbullakët në Suharekë. <http://elibraria.org/assets/Lista-e-votuesve-n%C3%AB-Kosov%C3%AB.pdf>; f.8.

²⁶ Koha Ditore. 7 maj 2013. KQZ pastron listat e votuesve, largon 30 mijë emra. <http://www.kohaditore.com/?page=1,13,144991>

²⁷ Krasniqi, Besnik. 7-8 gusht 2013. Kosova me 140 mijë votues më shumë. Koha Ditore. <http://elibraria.org/assets/2013-08-07-Kosova-me-140-mij%C3%AB-votues-m%C3%AB-shum%C3%AB.pdf>, f. 1.3.

²⁸ Komisioni i Venedikut. 23 maj 2003. Kodi i praktikës së mirë në çështje zgjedhor: Raport me udhëzime dhe shpjegime (Code of Good Practice in Electoral Matters: Guidelines and Explanatory Report). CDL-AD (2002). Opinioni nr. 190/2002. http://www.regjeringen.no/upload/KRD/Kampanjer/valgportal/valgobservatorer/Code_of_good_practice_CDL_AD%282002%29023rev_e.pdf; Pika 1.2iii, f. 6.

European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission). 23 May 2003. Code of Good Practice in Electoral

Matters: Guidelines and Explanatory Report. CDL-AD (2002).
Opinion no. 190/2002.

http://www.regjeringen.no/upload/KRD/Kampanjer/valgportal/valgobservatorer/Code_of_good_practice_CDL_AD%282002%29_023rev_e.pdf; Point, 1.2iii, page. 6.

²⁹ Rrustemi, Adnan. 31 maj 2013. Lista e votuesve në Kosovë. [Prezantuar nga autori në tryezë të rrumbullakët në Suharekë]. <http://elibraria.org/assets/Lista-e-Votuesve-n%C3%AB-Kosov%C3%AB.pdf>; f. 11.

30 PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 10, faqe 2.

³¹ Kuvendi i Kosovës. 5 qershor 2008. Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-073). http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-Lo73_al.pdf, Neni 90.

³² PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 10, faqe 2.

³³ PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 10, faqe 2.

³⁴ PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve

anëtare të BE-së të përfaqësuar në Prishtinë.
<http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 10, faqe 2.

³⁵ Komisioni Evropian. 12 tetor 2011. Kosovo Progress Report (Raporti i Progresit për Kosovën).
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf. Page 6.

³⁶ PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuar në Prishtinë.
<http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 10, faqe 2.

³⁷ PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuar në Prishtinë.
<http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 10, faqe 2.

³⁸ PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuar në Prishtinë.
<http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 10, faqe 2.

³⁹ EU EEM. 25 January 2011. Final Report. European Union Election Expert Mission in Kosovo.
http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/25012012_final_report_eu_eem_kosovo_2010. Page 29.

⁴⁰ PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuar në Prishtinë.

<http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 13, faqe 2.

⁴¹ PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë.

<http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 13, faqe 2.

⁴² PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë.

<http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 13, faqe 2.

⁴³ PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë.

<http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 13, faqe 2.

⁴⁴ Musliu, Betim dhe Adem Gashi. Qershor 2012. Krimi i organizuar në zgjedhje: analizë e ndjekjes së politikës së dënimeve. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD).

<http://elibraria.org/assets/IKD-Krimi-i-organizuar-ne-zgjedhje-raporti.pdf>; f. 6.

⁴⁵ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 5 qershor 2012. Mbledhja nr. 40 në vitin 2012. [Shënimet e marra nga D4D gjatë mbledhjes]. <http://elibraria.org/assets/2012-06-05-Mbledhja-nr.-40-n%C3%AB-vitin-2012.pdf>; p 2.

⁴⁶ PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 6, faqe 1.

47 PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, Pika 11, faqe 2.

48 European Commission. 8 February 2013. Report from the Commission to the European Parliament and the Council on progress by Kosovo in fulfilling the requirements of the visa liberalisation roadmap. COM(2013) 66. http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/e-library/documents/policies/international-affairs/general/docs/report_on_progress_on_kosovo_visa_liberalisation_en.pdf; p. 19.

49 Pula, Erëza. Maj 2013. Financing of Political Parties in Kosovo – can controllability and transparency help? (Financimi i partive politike në Kosovë – a mund të ndihmojnë kontrolli dhe transparenca?) Group for Legal and Political Studies/Grupi për Studime Juridike dhe Politike. <http://elibraria.org/assets/Financing-of-Political-Parties-in-Kosovo1.pdf>; p. 8.

50 PSBE/Shefi i Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë. Prill 2013. Memorandum liderëve partiak për procesin e reformës zgjedhore nga PSBE/Shefi i Zyres Evropiane dhe të shteteve anëtare të BE-së të përfaqësuara në Prishtinë. <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf>, faqe 2.

Lista e publikimeve

Zgjedhjet:

#1: Instituti Demokraci për Zhvillim. Shtator 2011 Zbërthimi i trendeve zgjedhore 200-2010

#2: Instituti Demokraci për Zhvillim. Mars 2012. Reformë sa për adet: Si ta rikthejmë besimin në zgjedhje?

#3: Leon Malazogu, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. Auditimi i listës së votuesve të Kaçanikut: Mostër për Kosovën

#4: Leon Malazogu dhe Selatin Kllokoqi, Shkurt 2013. Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme – Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik?

Marrëdhëniet Ndëretnike:

#1: Leon Malazogu dhe Vladimir Todorić, Nëntor 2011. Dialogu Beograd – Prishtinë: Nevojitet transformim i interesit vetanak

#2 Leon Malazogu, Viktor Popović dhe Shpend Emini. Mars 2012. Perspektiva e një të riu serb në Kosovë/Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë

#3 Leon Malazogu dhe Florian Bieber. Shtator 2012. Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen

#4: Leon Malazogu dhe Alex Grigorev me kontribut nga Drilon Gashi. Shtator 2012. Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen PER-K/ D4D Institute.

#5: Leon Malazogu dhe Alex Grigorev. Shtator 2013. Nga paqartësia kreative në proces konstruktiv – Si ti qasemi veriut të Kosovës? PER-K/D4D Institute

Interesi publik:

#1: Dardan Sejdiu dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. ‘Taksa’ e fshehur: pse kosovarët paguajnë më shumë?

#2: Drilon Gashi dhe Shoghi Emerson. Janar 2013. Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë

#3: Visar Sutaj dhe Leon Malazogu. Janar 2013. Le të ngritet shoqëria civile e vërtetë! Roli i shoqatave me anëtarësi në formësimin e vendimmarrjes në shërbim të interesit publik.

Memorandumet:

#1: D4D. Nëntor 2012. Memorandum reagues. Nr.1. Reagim i tepruar i policisë

#2. D4D. Dhjetor 2012. Memorandum reagues. Nr.2. Modeli i dy Gjermanive.

#3: D4D. Korrik 2013. Memorandumi reagues. Nr.3. Kritere të qarta për komuna të reja

Indikatorët:

#1: D4D. Nëntor 2010. Para dhe Pas-Performanca e bazuar në indikatorë: Vlerësimi vjetor 2010.

#2: D4D. Shteti në Pasqyrë: Indikatorët e Bazuar në Performancë

D4D në publikime tjera:

SüdstEuropa Mitteilungen. 05-06 2012.



Leon Malazogu dhe Florian Bieber.

Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen.

Forumit 2015. Seria e analizave “Çka shkoi ters?”

Top problemet zgjedhore. Qasje praktike për të kthyer besimin në procesin zgjedhor

Seria: Zgjedhjet



Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

324(496.51)

Deforma zgjedhore : Dy vite pas, reforma në pikën zero / [Përgatitur nga Leon Malazogu dhe Selatin Kllokoqi me përkrahje hulumtuese nga Rasim Alija]. - Prishtinë : Demokraci për Zhvillim, 2013. – 68 f. ; 21 cm.

1. Malazogu, Leon 2. Kllokoqi, Selatin 3. Alija, Rasim

ISBN 978-9951-608-18-3

Demokraci për Zhvillim (D4D) është një institut hulumtues i themeluar në vitin 2010 me besimin se demokracia është parakusht për zhvillim. Themeluesit e D4D besojnë se demokracia është mjet dhe qëllim për zhvillim dhe janë të përkushtuar që të hulumtojnë dhe të përfshijnë një komunitet më të gjerë drejt këtij qëllimi.

Misioni i D4D-së është të ndikojë në proceset e zhvillimit të politikave publike në mënyrë që të përshpejtojë zhvillimin socio-ekonomik të vendit, përmirësimin e qeverisjes dhe për të përforcuar kulturën demokratike në Kosovë.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA

ISBN 978-9951-608-18-3



9 789951 608183